VENDIM
Nr. 27, datë 16.2.2015

MBI MIRATIMIN E TARIFËS FIKSE TË ENERGJISË, PËR VITIN 2015, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme", të ndryshuar, nenit 111, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 11.2.2015 "Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet"; Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2015, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve mbi tarifën fikse të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike për vitin 2015,

VENDOSI:

1. Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2015, do të jetë 7.636 lekë/kWh.
2. Vendimi nr. 5, datë 26.1.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes se energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW", dhe vendimi nr. 24, datë 11.4.2007, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW" shfuqizohen.
3. Ngarkohet KESH sh.a. dhe prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga 1.1.2015 deri më 31.12.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti